



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Januar - Prilljeto 2016 22.11.2016 (14.god.)

Titulli i organit / Org.broj	Numeri/Broj	Shtojcë / Prilog	Vlera / Vrednos
	01-013/1501		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d) neni 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, dhe neni 36 paragrafi 36.2, shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seancën e mbajtur më 22.11.2016, aprovon këtë:

V E N D I M

Për shpalljen në diskutim publik për propozimin për ndryshimin e rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Vitisë

Neni I

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë, MIRATON vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik propozimin për ndryshimi e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Vitisë.

Neni II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është materiali për propozimin për ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Vitisë, me numër të protokollit 02-013/1410, i datës 09.11.2016.

Neni III

Të drejt pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë, në afat prej 15 dite duke llogaritur nga dita e par e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Hapja e shqyrtimi publik do të bëhet më datën 15.12.2016 (e enjte), në sallën e Kuvendit Komunal në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti, duke filluar nga ora 10:00.

Neni IV

Pas përfundimit të kohës për shqyrtim, komentim dhe finalizim të tij, propozim i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratim final.

Neni V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni VI

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit
2. Drejtorisë për Financa, Ekonomi
3. MAPL
4. Shërbimit të Kuvendit
5. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

